



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 114 Prot.  
2024

Tiranë, më 19 . 01 .

### V E N D I M

**Nr. 22 , datë 19 . 01 . 2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 275 Regj., datë 26.12.2023<sup>1</sup>, të shtetasit M. B, kundër: Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Komandës së Forcës Ajrore, Rinas, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, M. B, me gradë Nënkolonel, pranë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë mban detyrën “Oficer Shtabi për Vëzhgimin Ajror”, në Degën e Zbulimit, në Shtabin e Forcës Ajrore/FA<sup>4</sup>.

Në parashtrimet e depozituara pranë KMD-së, ankuesi ka paraqitur një kronologji të gjatë të situatës dhe shqetësimit të tij, duke filluar që nga viti 2019, me marrjen e masave disiplinore kundrejt tij, për të cilat dhe ka pretenduar se diskriminohet, ndër vite.

<sup>1</sup> Plotësuar nga ankuesi nëpërmjet e-mailit datë 09.01.2024.

<sup>2</sup> Pa përcaktuar, shpjeguar apo dokumentuar se çfarë pretendon a justifikon subjekti ankues me këtë shkak.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

<sup>4</sup> Referuar Urdhrit nr. 1130, datë 25.07.2022 “Për lirim dhe emërim në detyrë”, të Ministrit të Mbrojtjes.

Kështu, referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, në kronologji kohore, evidentohen veprimet si më poshtë citohen:

- Me Urdhrin nr. 474, datë 01.04.2019 “Për lirim nga detyra”, të Ministrit të Mbrojtjes, është urdhëruar: *“Nënkolonel M. B, me detyrë “Oficer Shtabi për Sigurinë e Personelit dhe Sigurinë Industriale”, në Drejtorinë e Zbulimit (J-2), në Shtabin e Përgjithshëm, lirohet nga kjo detyrë dhe kalon në dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.”*
- Me Urdhrin nr. 517, datë 07.05.2019 “Për dhënie mase disiplinore”, të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, është urdhëruar që: *“Nënkolonel M. B, aktualisht në dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për shkeljen disiplinore të parashikuar në germën g), të nenit 11, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i jepet masa disiplinore “Qortim”, parashikuar në germën a), të pikës 1, të nenit 14, të ligjit sipërcituar.”*
- Me Urdhrin nr. 517/1, datë 07.05.2019 “Për dhënie mase disiplinore”, të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, është urdhëruar që: *“Nënkolonel M. B, aktualisht në dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për shkeljen disiplinore të parashikuar në germën j), të nenit 11, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i jepet masa disiplinore “Punë jashtë orarit”, parashikuar në germën c), të pikës 1, të nenit 14, të ligjit sipërcituar.”*
- Me shkresën me nr. 3487/1 prot., datë 13.05.2019, me lëndë “Raportim i shkeljes shumë të rëndë disiplinore”, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, i është drejtuar Ministrit të Mbrojtjes, duke i bërë me dije situatën si më poshtë:

*“Mbështetur në raportimin e bërë nga Kolonel L. Xh, me funksion “SNR në KFOR”, ju njoftojmë se, Nënkolonel M. B, aktualisht në dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm, pretendohet se ka kryer shkelje të rëndë disiplinore...” ushtrim i dhunës fizike të paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune ndaj një personi tjetër, në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari.”*

*Për Nënkolonel M. B ky raportim është i treti brenda një viti pas dy masave disiplinore të dhëna ndaj tij. Kjo shkelje konsiderohet si shkelje shumë e rëndë e tij (pika2, e nenit 12, të ligjit nr. 173/2014).*

*Bazuar në kreun V-të të Udhëzimit të MM, me nr. 5, datë 22.04.2015, ushtaraku është thirrur dhe bërë me dije për raportimin e shkeljes disiplinore, duke i komunikuar formularin standard (VPD model 1) në të cilin ishte bashkëlidhur formulari për raportimin e shkeljes disiplinore.*

*...ju raportojmë sa më lart, për vijimin e procedurave të mëtejshme.”*

- Me Urdhrin nr. 1078, datë 12.07.2019 “Për dhënie mase shumë të rëndë disiplinore”, të Ministrit të Mbrojtjes, është urdhëruar: *“Dhënia e masës shumë të rëndë disiplinore “Ulje e pagës dhe trajtimin me pagë mujore për periudhën 01.07.2019 deri më datë 30.06.2020”, në ngarkim të Nënkolonel M. B, aktualisht në dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së...”*
- Me Urdhrin me nr. 1405, datë 12.09.2019 “Për emërim në detyrë”, të Ministrit të Mbrojtjes, Nënkolonel M. B, aktualisht në dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm të

FA, emërohet me detyrë “Specialist për Sigurinë e Fluturimit”, në Degën e Sigurisë së Fluturimit, në Repartin Ushtarak Nr. 3001, në Komandën e FA.... “Për periudhën 01.07.2019 deri më datë 30.06.2020, të trajtohet me pagën e Majorit, në zbatim të Urdhrit nr. 1078, datë 12.07.2019 “Për dhënie mase shumë të rëndë disiplinore”, të Ministrit të Mbrojtjes.”

- Ankuesi, me datë 30.06.2020, nëpërmjet shkresës me lëndë: “Kërkesë për interpretim urdhri” i është drejtuar Shefit të Përgjithshëm të FA, duke kërkuar prej tij një përgjigje shteruese, lidhur me dy masat disiplinore të datës 07.05.2019.
- Me kthim përgjigjen me nr. 3770/1 prot., datë 20.07.2020, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA (SHPFA), evidentohet se ankuesit i është bërë me dije se, është në kushtet e tejkallimit të çdo afati të arsyeshëm për ankimimin e akteve administrative, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe për pasojë kërkesa e tij nuk merret parasysh.

Subjekti ankues, ndër të tjera, parashton se: “Nga ky moment, si person i interesuar kam dërguar disa herë për një periudhë rreth 4 vjeçare, kërkesë për informacion pranë SHPFA dhe MM (Ministrisë së Mbrojtjes), drejtuar Koordinatorit për Informimin, me anë të të cilave kam kërkuar të më jepet mundësia të ushtroj të drejtën për t’u njohur me informacion (shkresa, prova, fakte, deklarata, e-mail, fax, etj) që kanë të bëjnë me personin tim, lidhur me ecurinë e masave të mia disiplinore, të cilat administrohen nga SHPFA, konform rregullave e ligjeve në fuqi.

SHPFA dhe MM, jo vetëm që nuk kanë dhënë këtë të drejtë ligjore themelore, por zyrtarisht me shkresa të ndryshme “Kthim përgjigje”, disa prej tyre në tejkallim të afatit ligjor, më kanë penguar për t’i patur ato, duke më dhënë argumente të ndryshme nga shkresa në shkresë, pa referenca të qarta mbi bazën ligjore në fuqi.

Këmbëngulja ime prej vitesh tashmë, për t’u njohur me dokumentacionin, ka bërë që titullarë e drejtues të ndryshëm në MM dhe SHPFA të ushtrojnë diskriminim të vazhdueshëm ndaj personit tim me mënyra të ndryshme dhe me akte përkatëse, duke mos ndjekur praktikat shkresore që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave, procedurave dhe kriterëve për emërimin e personelit në FA. Nga zbatimi e moszbatimi i këtyre politikave dhe procedurave të miratuara, rezulton se unë, si ushtarak aktiv i FA, që prej vitit 2019 kam ndërruar 4 pozicione funksionale organike, në kundërshtim me afatet minimale dhe maksimale të qëndrimit në detyrë dhe shkelje të tjera ligjore nga këto organe.

Sikurse sa më sipër, përgjatë gjithë kësaj periudhe jam ndier dhe jam diskriminuar nga autoritetet përgjegjëse, drejtuesit përkatës dhe jo vetëm në Ministrinë e Mbrojtjes e Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, por edhe strukturat vartëse të tyre. Diskriminimi ka të bëjë me pengimin me njohjen e dokumentacionit, por edhe me metodat e përdorura prej tyre mbi aktet përkatëse. Ky diskriminim mund të konfirmohet nga korrespondenca ime e gjatë shkresore.

....Unë nuk mund të përcaktoj qartë shkaqet e përcaktuara sipas LMD-së, për këtë arsye kam zgjedhur “çdo shkak tjetër”. Në formimin tim, vetë pengimi për njohje me dokumentacionin, në kundërshtim të procedurave ligjore dhe të parimeve njerëzore është diskriminim i vazhdueshëm. Në gjykimin tim, brenda këtyre shkresave ka qartazi persona të cilët janë përfshirë, apo kanë konsumuar elementë të veprave penale si “shpërdorim të detyrës” dhe

*“fallsifikim të dokumenteve”, gjë që mund të jetë edhe arsyeja që këta persona dhe “të besuarit” e tyre vazhdojnë të më diskriminojnë në vijimësi.”*

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Komandës së Forcës Ajrore, Rinas.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, në raport me secilin nga subjektet nga të cilët pretendon se diskriminohet.

- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 03.01.2024, KMD, i ka kërkuar subjektit ankues të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë informacionin e nevojshëm, përsa i takon lidhjes së pretenduar të trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm nga secili nga subjektet kundër të cilëve ka paraqitur ankesën pranë KMD-së.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nëpërmjet e-mailit datë 09.01.2024, subjekti ankues ka dërguar shpjegimet si më poshtë vijojnë:

*“Do mundohem të jap disa shpjegime mbi kronologjinë e akteve e ngjarjeve të referuara prej meje:*

*Urdhri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, nr. 517/1, datë 07.05.2019 “Dhënie mase disiplinore”, protokolluar në SHPFA me nr. 2930/2, datë 06.05.2019, nuk është thjesht një akt administrativ i cili mund të përcaktojë qartë shkakun ose shkaqet për të cilat pretendohet diskriminimi, por pas këtij akti të nxjerrë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, më ka ndodhur një diskriminim i gjatë në kohë dhe i strukturuar nga drejtues dhe persona të ndryshëm. Unë vërtet e kam dërguar në gjykatë këtë akt dhe të tjerë për pavlefshmëri të nxjerrjes së tyre, ama ky akt edhe nëse bie poshtë nga gjykata e ka pasur efektin e tij diskriminues ndaj meje.*

*Ky dokument vërtet ka dalë në një kohë të caktuar, por unë nuk mund t'a shlyeja punën jashtë orarit duke qëndruar në shtëpi. Kur unë kam shkuar në punë jam drejtuar tek pesonat konkret për punën konkrete, afatin, dhe mënyrën e kryerjes së saj. Për gjashtë muaj drejtues të ndryshëm kanë kryer veprime të dukshme diskriminuese ndaj meje duke e interpretuar këtë akt sipas dëshirave dhe ideve të tyre personale. Veprimet e tyre kanë shkuar deri aty sa ato kanë kërkuar që unë të mos përdor të njëjtin mjet transporti kolektiv të institucionit për kthimin në shtëpi mbasdite me argumentin se kam punë jashtë orari. Ndodhur në këto kushte i jam drejtuar autoritetit i cili e ka nxjerrë këtë akt me një shkresë të emërtuar Aa 20200630, Kërkesë SHSHPFA, për interpretim urdhri, bashkë me përcaktimet ligjore dhe nënligjore për këtë masë disiplinore, ku kam kërkuar që në përmbushje të detyrimeve ligjore, titullari përkatës, si autoriteti përgjegjës për dhënien e masës, të më përcaktonte punën konkrete, afatin, dhe mënyrën e kryerjes së saj. Ky autoritet më ka kthyer përgjigje me shkresën e emërtuar Ab 20200720, Kthim Përgjigje SHSHPFA, ku nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës*

time, nëse kjo punë konkrete është kryer nga ana ime, është amnistuar, konvertuar, apo është përdorur vetëm urdhri (si dokument) për diçka tjetër.

Shkresa e dytë, emërtuar B 20210412, Informacion SHSHPFA, mbi një faqe në Facebook. Ky dokument është një shkresë e imja drejtuar Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, lidhur me një faqe në Facebook e cila përdor website-in e Forcave të Armatosura (<http://aaf.mil.al/>), si link kontakti të saj. Për këtë shkresë e cila është dorezuar me postë nuk kam marrë asnjë përgjigje edhe pse unë kam ndjekur reagimet që kanë ndodhur pas shqetësimit tim.

Shkresa e tretë, emërtuar C 20220801 Ankesë/Kërkesë e imja për lirim dhe emërim në detyrë...

Gjithçka është e sqaruar në këtë shkresë, se kush janë procedurat dhe kush është personi im në lidhje me këto procedura.

...

Falje për zgjatjen, por unë nuk mund dhe nuk dua që të lidh një shkak apo disa shkaqe me dokumente, akte konkrete, në mënyrë të palogjikshme. Kam menduar se me vendosjen e “çdo shkak tjetër”, në ankesë mund të argumentoj apo dokumentoj cilësitë dhe rrethanat sipas meje diskriminuese.”

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare\_ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon

ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Komisioneri vëren se, Vendimmarrja e KMD-së arsyetohet dhe e argumentohet mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Neni 246, i Kodit të Procedurës Civile “Fuqia provuese e shkresave”, përcakton se, shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre.

Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se, do të konsiderojë prova të cilave iu është referuar në analizën e tij, në kontekst të provueshmërisë së vërtetësisë së tyre, vetëm ato shkresa e akte që plotësojnë elementët e nevojshëm dhe janë hartuar në formën e caktuar ligjore.

***Bazuar në analizën e deklarimeve të depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:***

*Së pari*, sa i takon pretendimit të ankuesit se është diskriminuar për sa i takon procedurës, veprimeve e mosveprimeve lidhur me dhënien e masave disiplinore kundrejt tij, nga ana e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur dhe ankesën, ato lidhen me periudhën kohore kur janë dhënë e komunikuar ankuesit. Kështu, të dyja masat disiplinore të cilave iu referohet ankuesi, datojnë në periudhën maj-shtator 2019, periudhë në të cilën dhe ka marrë dijëni, pasi i ka kundërshtuar ato qoftë administrativisht, qoftë gjyqësisht (sipas deklarimeve të vetë ankuesit).

- Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, të gjitha pretendimet që burojnë nga këto masa dhe pasojat e ardhura nga veprimi a mosveprimi i subjekteve ndaj të cilave ankuesi ka pretenduar sjelljet diskriminuese, lidhen pazgjidhshmërisht me periudhën kur ato supozohet se kanë ndodhur (vitin 2019), dhe për sa i takon të drejtës së kundërshtimit të tyre, ndiqet e drejta e ankimimit brenda afateve të caktuara ligjore.

- Subjekti ankues është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA, që në muajin maj 2019<sup>5</sup>, kohë kur dhe i është njoftuar urdhri përkatës. E njëjta logjikë vlen edhe për Urdhrat e tjerë që datojnë në periudhën maj-shtator 2019<sup>6</sup>.
- Në kontekst të sa mësipër, ankuesi ka marrë dijeni për masat disiplinore, qoftë procedurën e ndjekur, qoftë veprimet e mosveprimet e instancave përkatëse lidhur me përmbajtjen e masave e dokumentacionin përkatës (*fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin*), që në vitin 2019, kur ato janë formalizuar si të tilla dhe i janë komunikuar ankuesit. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 26.12.2023, pra më vonë se dy vite nga marrja dijeni. (*Konkretisht më shumë se 3 (tre) vite nga momenti i ndodhur*).

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetasit M. B, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Së dyti, sa i takon pretendimit të ankuesit lidhur me Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes me nr. 1130, datë 25.07.2022 “Për lirim dhe emërim në detyrë”, për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, pa dokumentuar dhe paprovuar shkakun, Komisioneri vlerëson se thjesht citimi i “çdo shkakut tjetër”, i pa argumentuar nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkak” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh<sup>7</sup>. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

<sup>5</sup> Urdhri nr. 517, datë 07.05.2019 “Për dhënie mase disiplinore”, i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Urdhri nr. 517/1, datë 07.05.2019 “Për dhënie mase disiplinore”, i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

<sup>6</sup> Shkresa me nr. 3487/1 prot., datë 13.05.2019, me lëndë “Raportim i shkeljes shumë të rëndë disiplinore” e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA; Urdhri nr. 1078, datë 12.07.2019 “Për dhënie mase shumë të rëndë disiplinore”, i Ministrit të Mbrojtjes; Urdhri me nr. 1405, datë 12.09.2019 “Për emërim në detyrë”, i Ministrit të Mbrojtjes.

<sup>7</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me .....ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh<sup>8</sup>.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi<sup>9</sup> karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë. Ankuesi ka shpjeguar se me këtë shkak lidh paligjshmëritë dhe veprimet e kryera kundrejt tij, dhe pohon se nuk arrin ta identifikojë shkakun apo arsyen e vërtetë por vetë shkresat e dokumentojnë këtë paligjshmëri.

---

<sup>8</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

<sup>9</sup> “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.



Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

*“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë<sup>10</sup>”*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi respektivisht edhe për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon

<sup>10</sup> Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Pala ankuese nuk provon me fakte e prova se mbart shkaqet e pretenduara, sipas përcaktimeve të LMD-së. Në kuptim të LMD-së, *“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.”*<sup>11</sup>.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se:

*“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) .....nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

*Së treti*, lidhur me pretendimin e ankuesit për moskthimin e përgjigjes ndaj kërkesave të tij nga ana e subjekteve kundrejt të cilëve ka pretenduar diskriminim, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Pretendimi i ankuesit lidhet me mosmarrjen përgjigje të kërkesave/ankesave të tij nga ana e institucioneve sipërcituar, si dhe në disa raste, kur ato kanë kthyer përgjigje, kanë qenë jashtë afateve ligjore për kthimin e përgjigjes.

Komisioneri vëren se, veprimi me vonesë (jashtë afateve ligjore) apo mosveprimi i këtyre subjekteve, ka të bëjë me moszbatimin e shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me pretendimin e ankuesit, se institucionet sipërcituar, nuk i janë përgjigjur kërkesave të tij; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr.

<sup>11</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

119/2014 “Për të Drejtën e Informimit<sup>12</sup>”, të ndryshuar, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDMDHP).

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të shtetasit M. B për moskthim përgjigje nga ana e institucioneve, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>13</sup>.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankuesit për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t’i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit.

Së fundmi, lidhur me pretendimin e ankuesit se: *“...ka qartazi persona të cilët janë përfshirë, apo kanë konsumuar elementë të veprave penale si “shpërdorim të detyrës” dhe “fallsifikim të dokumenteve”*, Komisioneri vëren se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.<sup>14</sup>

---

<sup>12</sup> Neni 24, të këtij Ligji, parashikon se: *“Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, KDMDHP ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. KDMDHP merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. Në qoftë se KDMDHP nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk cënon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”*

<sup>13</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së, Vendimin nr. 225, datë 22.12.2022, të KMD-së, etj.

<sup>14</sup> Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale....”*

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”.*

Neni 248<sup>15</sup>, i po këtij Kodi, përcakton se: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.”*

Neni 186<sup>16</sup>, i Kodit Penal, përcakton se: *“Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet.”*

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.”*

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ...”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronjat b), ç) e dh), nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

---

<sup>15</sup> “Shpërdorim i detyrës”

<sup>16</sup> “Falsifikimi i dokumenteve”

## **VENDOSI:**

1. Mospranimin e ankesës së z. M. B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**